



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 151, dt. 12.05.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, date 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 12.05.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për ndryshim të drejtuesit ligjor të licencës në fushën e restaurimit për Shoqërinë “ATELIER 4” shpk, me drejtues teknik Ark. Alban Efthimi (RP.49),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për ndryshim të drejtuesit ligjor të Shoqërisë “ATELIER 4” shpk me drejtues ligjor Z. Alban Efthimi.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për ndryshim të drejtuesit ligjor të Shoqërisë “ATELIER 4” shpk me drejtues ligjor Z. Alban Efthimi.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI